



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE

Nr. 287P prot.

Tiranë, më 26.4.2024

Lënda: Mbi kërkesën për heqje nga fondi pyjor për aktivitetet minerar

BASHKISË KUKËS

Për dijeni: **SHOQËRISË "PEPA GROUP" sh.p.k.**
Autostrada Tiranë-Durrës km6, rruga dytësore "Iliria", Kashar, TIRANË

Në vijim të kërkesës së shoqërisë "Pepa Group" sh.p.k. ardhur nëpërmjet aplikimit on-line, datë 25.04.2024, lidhur me procedurën e heqjes nga fondi pyjor publik për zhvillimin e aktivitetit minerar, në objektin "Surroj", në Bashkinë Kukës, dhe Lejes Mjedisore të tipit B nr.3044/1, datë 1.08.2023, ju informojmë se:

Bazuar në Ligjin nr.57/2020 "Për Pyjet", datë 30.04.2020; në VKM nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre"; në VKM nr. 684, datë 2.09.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.433, datë 8.06.2016 "Për transferimin sipas listave të inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive, në pronësi të bashkive"; në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondi pyjor dhe kullor publik", nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, kërkohet përgatitja e raportit tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore e cila do të përdoret për kryerjen e aktivitetit minerar sipas relacionit të shoqërisë dhe miratimit nga AKBN për sipërfaqen e reduktuar, që hiqet nga fondi pyjor publik, e cila ndodhet brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit të miratuar nga MIE me lejen nr. 1886/1, date 7.02.2023.

Një kopje e dokumentacionit të përgatitur dërgohet pranë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit për vijimin më tej të procedurave të heqjes nga fondi pyjor dhe pakësimin në volum.

0277

Dërgimi i raportit tekniko-ekonomik duhet të shoqërohet dhe me dakortësinë me vendim të Këshillit të Bashkisë, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III, të V.K.M. nr. 888, datë 27.12.2022, i cili duhet të përmbajë të dhënat kadastrale për sipërfaqen që hiqet.

Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin ligjor dhe teknik të depozituar nga shoqëria.

Lutemi kryerjen e procedurave të cituara më lart, **brenda afateve ligjore** të përcaktuara në VKM nr.888/2022, kapitull II, pika 6.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

LEDINA BEQIRAJ AGALLIU

